



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.298/16

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, e përberë nga kryetari i trupit gjykues gjyqtari profesionist Shaban Shala dhe anëtarëve Resmije Rrema dhe Skender Cana, si gjyqtarë porot, me praktikantin Canë Vorfaj, duke vendosur në çështjen juridike të paditëses Rre [redacted] (H [redacted]) Me [redacted] me banim në Zvicërr Bachtelstrasse 6. Dietlikon, të cilën e përfaqëson av. P [redacted] P [redacted] nga Prizreni kundër të paditurit A [redacted] B [redacted] nga fsh. S [redacted] e [redacted], Komuna Prizreni, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av. F [redacted] Sh [redacted], lidhur me zgjidhjen e martesës me padi, pas shqyrtimit kryesor jo publik të mbajtur me datën 27.10.2017, morri dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I. APROVOHET kërkesë PADIA si e bazuar dhe ZGJIDHET martesë me shkurorëzim e lidhur në mes të paditëses Rre [redacted] Me [redacted] e lindur me dt. 13.10.1994 në fshatin A [redacted], Komuna e Malishevës, tani më vendbanim në Zvicërr Bachtelstrasse 6. Dietlikon dhe të paditurit A [redacted] B [redacted] nga fsh. S [redacted], Komuna Prizreni i lindur me dt. 19.01.1990 martesë kjo e lidhur me datë 15.12.2015 pranë zyrës së vendit në fsh. Velezhë Komuna Prizreni, me numër rendor [redacted].

II. Secila palë i bart shpënzimet e veta procedurale.

Arsyetim

Paditësja në këtë gjykatë ka parashtuar padi kundër të paditurit me të cilën ka kërkuar zgjidhjen e martesës për shkak për shkak të çrregullimit të raporteve martesore.

Në shqyrtimet e mbajtura dhe seancën kryesore i autorizuari i paditëses av, P [redacted] ka deklaruar: se ngel në tërësi pranë padisë së parashtuar i propozon gjykatës që pas administrimit të provave ta provojë kërkesë padinë. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se janë plotësuar të gjitha kushtet për zgjidhjen e martesës në mes të palëve pasi që është vërtetuar se në mes tyre janë krijuar konflikte sikurse i ka përmendur në deklaratën e sajë vetë paditësja, e të cilat e kanë bërë të pa durueshme jetesën e mëtejshme bashkëshortore si dhe për shkak të mospërputhjes të karaktereve të tyre, e po ashtu duke pasur parasysh edhe faktin se të

1000

1000 1000 1000 1000 1000

1000 1000

1000 1000

1000 1000

1000 1000

1000 1000

1000 1000

1000

1000

njëjtut nuk kontaktojnë në mes veti prej shkurtit të vitit 2006. Shpenzimet procedurale nuk i ka kërkuar.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit av. F. Sh. në shqyrtimet e mbajtura dhe në seancën kryesore ka deklaruar: se mbetet si në përgjigjen në padi, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit të provave, e sidomos pas dëgjimit të paditëses dhe prindit të paditurit D. B. të dhënë në shqyrtimin kryesor më dt. 15.06.2017, e në pamundësi të dëgjimit të paditurit thekson se në këtë çështje juridike nuk janë plotësuar asnjë nga shkaqet e shkurorëzimit të papara me dispozitën e nenit 69 par.2 të Ligjit për Familjen andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesë padia e paditëses të refuzohet si e pabazuar. Shpenzimet i ka kërkuar.

Gjykata në shqyrtimin kryesor më qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejt të gjendjes faktike ka administruar këto prova: ka bërë dëgjimin e dëshmitarit D. B., ka bërë dëgjimin e paditëses R. M., ka bërë leximin e certifikatës martesore nr. 1, ka bërë leximin e raportit të Stacionit Policor në Veri lidhur me A. B. dhe pas analizimit dhe vlerësimit të provave një nga një dhe të gjitha së bashku si të ndërlidhura në kuptim të nenit 8 të LPK-së ka vendosur si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga deklarimi i dëshmitarit D. B. i cili ka deklaruar : se A. është njoftuar me R. në Zvicër para dy viteve, ku gjatë kësaj kohe djali tij ka qenë në Zvicër pasi që ka fituar azilin-vizën F, ku në Zvicër kanë bashkëjetuar rreth 2 vite, mirëpo R. për shkak të moshës së re dhe për shkak se ka pasur dokumentacion të Italisë nuk ka mundur të lidh kurorë. Shton se pas njoftimit dy të rinjtë janë fejuar, më pas paditësja ka mbetur dhe shtatzënë. Problemi qëndron në atë se pas fejesës kanë lindur probleme për shkak se babai i R. H. M. nuk ka qenë i pajtimit që këta të rinj të fejohen dhe martohen. Problem tjetër ka qenë se A. nuk ka mundur të pajiset me vizë për Zvicër për shkak se nuk i ka plotësuar kushtet sa i përket leje qëndrimit dhe punësimit. Gjithashtu dëshmitari shton se ka dy muaj që R. e A. nuk jetojnë së bashku dhe se kanë bërë përpjekje të vazhdueshme në drejtim të ruajtjes së kësaj martese dhe rregullimit të raporteve në mes rinjve. Nga kjo deklaratë gjykata vërteton faktin se të rinjt pas lidhjes së martesës kanë pasur probleme serioze e të cilat kanë ardhur në shprehje pasi që i padituri A. nuk ka pasur mundësi që të rregullon lejeqëndrimin në Zvicër.

Nga dëgjimi i paditëses në cilësi të palës e cila ka deklaruar: se me A. është njoftuar në muajin tetor të vitit 2014 në Zvicër, ndërsa në muajin dhjetor të vitit 2015 kanë lidhur kurorë, ku pas lidhjes së kurorës kanë filluar grindjet e ndërsjella ku si pasojë ajo është kthyer në Zvicër, ndërsa A. ka qëndruar në Kosovë. Mosmarrëveshjet me A. kanë qenë të natyrave të ndryshme, kërkonte para, ushtronte presion për ti rregulluar dokumentet, kurse një gjë e tillë nuk ka qenë e mundur për shkak se A. është dëbuar nga Zvicra. Shton se në shkurt të vitit 2016 pasi paraprakisht janë marr vesh kanë ardhur në Kosovë për ta prishur kurorën, por kur kanë shkuar tek av. P. A. nuk ka pranuar. Shton se pas njoftimit me A. kanë pasur në parim kontakte javore si gjithë të rinjt dhe se lidhjen e kurorës e ka bërë pa dijeninë e prindërve. Shton se nga muaji shkurt i vitit 2016 nuk ka pasur kurrfarë kontakti me A. ndërsa lidhur me bashkësinë faktike martesore një bashkësi të tillë asnjëherë nuk e kanë pasur që nga njoftimi, ngase gjithmonë ka jetuar në familjen e

87

prindërve të saj. Përfundimisht shton se është vullneti i saj i lirë për ta prishur kurorën ngase jeta më të është e pa mundshme nga rrethanat e cekura më lartë dhe se presion për ta zgjidhur martesën nuk ka nga askush duke përfshirë dhe prindërit.

Nga kjo deklaratë e paditëses gjykata vërteton faktet se është vullneti i lirë i paditëses për ta zgjidhur martesën, se me të paditurin ka pasur çrregullime serioze të raporteve dhe atë menjëherë pas njoftimit të tyre, se më të njëjtin faktikisht nuk ka krijuar bashkësi faktike martesore asnjëherë, ndërsa nga muaji shkurt i vitit 2016 nuk ka pasur kurrfarë kontakti qoftë edhe komunikim elektronik të cilës dëshmi gjykata ia fali besimin e plotë pasi që është e drejtë dhe në harmoni me gjendjen faktike.

Nga leximi i certifikatës së martesës më nr. rendor [redacted] gjykata vërteton faktin se palët ndërgjyqëse kanë lidhur martesë më dt.15.12.2015 në fshatin [redacted], Komuna e Prizrenit, ndërsa nga leximi i raportit të stacionit policor në Veri gjykata vërteton faktin se adresa e të paditurit është e saktë si në padi.

Për gjykatën nuk është kontestues fakti se palët ndërgjyqëse më datën 15.12.2015 kanë lidhur martesë dhe nga kjo martesë nuk kanë fëmijë të cilat fakte vërtetohen në bazë të certifikatës së martesës dhe deklarimit të palëve, por mbetet kontestues fakti sa i përket zgjidhjes së martesës, në këtë drejtim duke marr për bazë faktin se bashkësia faktike martesore nga data e lidhjes formale të martesës (15.12.2015) nuk është realizuar fare asnjëherë, për shkak të çrregullimit serioz dhe të vazhdueshëm si pasojë e presionit të vazhdueshëm të paditurit duke i kërkuar para paditëses dhe kërkesës për rregullimin e dokumentacionit e cila gjendje faktike vërtetohet në bazë dëgjimit të paditëses dhe pjesërisht nga deklarimi i dëshmitarit D [redacted] M [redacted] në pjesën e deklaratës kur shprehet se A [redacted] nuk ka mundur të pajiset me vizë për shkak qëndrimit dhe punësimit të tij në Zvicër të cilave prova gjykata ia fali besimin pasi që përkojnë me gjendjen e vërtetuar faktike se palët realisht nuk kanë realizuar martesën dhe se marrëdhëniet pas lidhjes së martesës janë çrregulluar seriozisht dhe në mënyrë të vazhdueshme, andaj gjykata e aprovoi kërkesë padinë si të bazuar dhe e zgjidhi martesën duke u bazuar në nenin 69 par.1 të Ligjit për Familjen i Kosovës.


Vendimi mbi shpenzimet e procedurës bazohet në dispozitat e nenit 450 të LPK-së për shkak se i padituri e ka humbur kontestin, ndërsa paditësja nuk i ka kërkuar shpenzimet.

Nga sa u cekë më lartë është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, e konform dispozitave të nenit 69, paragrafi 1 të Ligjit për familjen i Kosovës.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr. 298/2016 të dt. 27.10.2017


Praktikanti

Canë Vorfa



Kryetari i trupit gjykues

Shaban Shala



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.